

Përrurohet në gjuhën shqipe libri me kujtime i Dr. Hak Xha Han Mun, “NËNA E PAQES”

Hotel Tirana International, 31 tetor 2020



Të dashur Ambasadorë për Paqe, familje të bekuara, vëllezër dhe motra,

Me shumë kënaqësi dëshirojmë të ndajmë me ju lajmin e gëzueshëm së tashmë libri me kujtime i bashkëthemelueses së Federatës së Paqes Universale, Federatës së Familjes, Federatës së Grave dhe shumë organizatave të tjera ndërkombëtare Dr. Hak Xha Han Mun vjen në gjuhën shqipe për të gjithë dashamirësit dhe të apasionuarit e librit.

“NËNA E PAQES”, që fshin lotët e njerëzimit titullohet ky libër që përmbledh rrugëtimin e jashtëzakonshëm të Nënës Mun nga momentet e para të jetës së saj në një vend të shkatërruar nga lufta, përpjekja për mbijetesë duke u larguar si refugjate, bashkimi me bashkëshortin e saj Rev. Son Mjong Mun nën udhëheqjen e Zotit dhe rrugëtimin e tyre sëbashku si Prindër të Vërtetë për të sjellë shpresë dhe paqe në këtë botë të trazuar.

Pas 2 muajsh përkushtim intensiv nga përkthyesi i librit z. Sokol Rexhepi, dhe mbi një muaj redaktim nga një skuadër e vendosur dhe e përkushtuar për t’ia dalë në kohë, ne mundëm që të mbajmë eventin e promovimit të librit "Nëna e Paqes" ditën e shtunë më datë 31 tetor, në ambientet e Hotel Tirana.



Muaji tetor është i rëndësishëm për organizatat tona sepse ishte tetori i vitit 2005 që Prindërit e Vërtetë erdhën për herë të parë të dy së bashkë në Shqipëri. Ishte 31 tetori i vitit 2011 që ne promovuam në gjuhën shqipe Autobiografinë e Rev. Dr. Son Mjon Mun dhe ishte në tetorit e vitit të kaluar 2019 që Nëna Mun ishte në Shqipëri dhe shpalli kombin tonë si Shqipëria Qiellore.

Aktiviteti u zhvillua në sallën më të madhe të Hotel Tirana “Salla Akernia” me kapacitet 400 persona, por në respekt të protokolleve të sigurisë për shkak të pandemisë së covid19, vetëm 130 persona mundën të marrin pjesë.



Megjithatë, tashmë i gjithë aktiviteti tashmë gjendet online dhe mund ta shikoni atë në adresën:

<https://www.facebook.com/media/set/?vanity=ffpbshqiperi&set=a.3351968118256161>

Pjesëmarrës në aktivitetin përurues ishin Anëtarët e Këshillit Drejtues të Federatës së Paqes Universale, anëtare të Federatës së Grave Shqiptare për Paqes, Koordinatorët e Federatës së Familjes, Familje të Bekuara dhe të rinjtë nga W-CARP. Atmosfera ishte e mrekullueshme dhe programi i larmishëm bëri që koha të mos ndihej dhe të gjithë u bënë pjesë e emocioneve të singerta që përcollën referuesit dhe të rinjtë me performancat e tyre.

Pas një videoje prezantuese të përgatitur mbi librin, fjalën përshëndetëse në emër të Ambasadorëve për Paqe e mbajti Dr. Eva Çipi, Kryetare e Federatës së Paqes Universale e cila ndër të tjera tha se *“Ky libër është një dhuratë e çmuar, e cila na u dhurua në një moment kritik të qenësisë dhe historisë së njerëzimit, ku shumë trazira po e sfidojnë paqen midis qytetarëve. Kjo dhuratë është ushqim shpirti, dhe dritë për mendjen tonë. Është një dhuratë për mua, për juve të nderuar pjesëmarrës, dhe për të gjithë ata që nuk patën mundësinë të na bashkoheshin sot, ose për ata që ende nuk e kanë patur mundësinë e çmuar që të njihen me Prindërit e Vërtetë.*

E bukur, e re, e ëmbël, por edhe e fortë, luftëtare, e paepur është imazhi i saj që të ndjek gjatë gjithë leximit të librit. Ti lexon e lexon, hyn në histori, imagjinon dhe përpiqesh të gjesh qenien tënde në krah të këtij modeli. Dhe shikon se sa e vogël JE në staturë njerëzore, DHE KUPTON SE SA shumë KE nevojë të rritesh. Ja sesi Ajo përkufizon vetveten në misionin fisnik:

Natyra ime më detyron të jap gjithçka që kam për lumturinë e të tjerëve pa pritur asgjë në kthim. Unë e di kush jam: Nëna e Vërtetë, Nëna e Paqes dhe Bija e vetëmlindur e zotit dhe misioni im është të jetoj ashtu. Unë jam thirrur për të qenë si deti që pranon dhe përthith gjithë ujrat e lumenjve të mëdhenj e të vegjël, jam thirrur për të përqaftuar me zemrën e një prindi të gjithë ata që kanë humbur dhe nuk kanë askend që t'i mirëpresë.”



Më pas Dr. Saemira Pino, Kryetare e Komisionit të Akademikëve për Paqe pranë Federatës së Paqes dhe ish Ministre e Arsimit dhe Shëndetësisë, përcolli vlerësimet e saj të singërta për librin, duke qenë edhe një nga personat e përfshirë intensivisht në procesin e redaktimit. Dr. Pino tha: *“Në këto kohë të vështira që po kalojmë ne, si edhe bota, na vjen në shqip, si një dritë për të na kujtuar se gjithmonë ka shprese, libri me kujtime të Dr. Hak Xha Moon. Në Librin e znj. Moon ka shumë mesazhe paqeje si edhe shembuj të përvoja personale për paqebërje, që dëshmojnë me shpresë, se bota do ta arrijë paqen. Për nga kontributi me spektër të gjerë, Nëna Moon, mund të renditet ndër gratë më të shquara të kohës sonë. Për dekada të tëra vitesh përpigjet për bashkimin e dy Koreve dhe prosperitetin e tyre, ka mbajtur fjalë kurajoze për vlerat e besimit në Zot dhe antikomunizmin në ish Bashkimin Sovjetik, Kinë apo Korenë e Veriut, si edhe në vende të tjera të Azisë, Amerikës Latine, të Afrikës dhe pothuaj në të gjitha shtetet e Amerikës, përpara shtetarësh, udhëheqësish fetarë dhe qindra mijëra vetësh, ka kontribuar në themelime shkollash, gazetash, kompani biznesi, klinika e qendra shëndetësore, fabrika dhe ferma bujqësore, universitet, fondacione arsimore, akademi artistike etj. në të katër anët e globit.*

Pas disa performancave të mrekullueshme nga fëmijët e vegjël nga Tirana dhe të rinjve të CARP-it nga Elbasani, fjalën e radhës e mbajti z. Sokol rexhepi i cili foli si përkthyes dhe si përfaqësues i skuadrës së botimit të librit. Mes të tjerash ai thesroi *“Ndihej i privilegjuar që m’u dha mundësia për t’u shprehur sot mbi librin autobiografik ‘Nëna e Paqes’, jo vetëm si përkthyes i fillestar i kësaj shprehjeje të zemrës së Nënës së Vërtetë, por në radhë të parë si familje e bekuar dhe si anëtar i Federatës së Familjes në Shqipëri. Viti 2020 nuk ka qenë i lehtë, por gjithashtu nuk duhet të harrojmë se ky është edhe një vit jubilar në providencën e Zotit, duke shënuar 100 vjetorin e lindjes së Babait të Vërtetë, Reverendit Son Miong Mun dhe njëkohësisht botimin e këtij libri me kujtime të Nënës së Paqes, dr. Hak Xha Han Mun”.*



Përmes një video mesazhi, aktivitetin e përshëndeti edhe Presidenti i Federatës së familjes për Evropën dhe Lindjen e Mesme Dr. Michal Balkomb. Ndër të tjera Dr. Balkomb tha: *“Botimi i autobiografisë së Nënës Mun, ‘Nëna e Paqes’, është shumë i rëndësishëm. Megjithëse për shkak të pandemisë ne nuk mund të udhëtojmë dhe vizitojmë njëri-tjetrin lehtësisht, ne mund të lexojmë, dhe përmes këtij libri Nëna e Vërtetë dëshiron të ndajë thellësinë e zemrës së Prindit Qiellor. Unë besoj se kjo është diçka me të cilën Shqipëria dhe Ballkani mund të rezonojë vërtet. Ju e dini që Nëna Mun gjaët kësaj kohe ka zgjedhur të flasë për ‘Shpresën’ gjë e cila na mungon këto kohë. Mendoj se Zoti ka shpresë të jashtëzakonshme për shkak se Prindërit e Vërtetë janë këtu dhe për shkak se fëmijët besnikë të Prindërve të Vërtetë janë kudo dhe gjërat do të ndryshojnë patjetër. Prandaj le të ecim përpara me vetëbesim dhe me vendosmëri, dhe mbi të gjitha me gëzim të madh që kemi mundësinë të festojmë këtë pikë referimi në historinë e Providencës. Dhe, natyrisht, ne nuk duhet të harrojmë që një vit më parë Nëna e Vërtetë shpalli Shqipërinë Qiellore.*



Për të risjellë edhe një herë kujtimet e Samitit të Paqes rre vitit 2019 dhe vizitës së Nënës së Paqes në Shqipëri, u prezantua një video përmbledhëse e aktiviteteve të Samitit të Paqes.



Fjalën e mbylljes e mbajti znj. Manjola Vasmatics, Presidente e Federatës së Familjes në Shqipëri. Ndër të tjera znj. Manjola tha: *“Ju ftoj te imagjinoni pak rrugen e jetes se Nenes se Vertete, e cila si nje femije refugjat i mbijetoi luftes, imagjinoni nje nene qe ka humbur jo nje, por 4 femije. Ajo nuk do te donte as te jetonte me. Imagjinoni nje grua qe ka humbur bashkeshortin,... nje grua qe eshte perballur me sfida te panumerta... Dhe per me teper, te mendosh qe ne nje moshe te tille, 77-vjec, nje gjyshe do te donte te shijonte nipat dhe mbesat e veta. Kujtoj Nje vit me pare, kur Nena e Vertete erdhi ne Shqiperi, na tregoi se njerezit qe kishte perreth, nuk donin qe ajo te udhetonte per shkak te shendetit te perkeqesuar, por ajo erdhi sepse e dinte qe anetaret dhe AP e prisnin, dhe na tregoi qe ju desh te bente jo nje por dy gjilpera qe tem und te vinte, pasi duhet te vinte e te shpallte dicka te rendesishme. Ne keto kushte, ne mund te pyesim veten se si mundet ai njeri te vazhdoje perpara me nje vendosmeri te hekurt?! Eshte per shkak te asaj zemre qe e ben te harroje edhe se kujt i ka falur unazen e marteses, asaj zemre qe do te mbuloje me batanije cdo femije ne bote, qe do te haje ne nje tryeze me seciln prej nesh si dhe eshte per shka te urgjences per te permbushur ate premtim qe i beri Zotit dhe Babai te Vertete. Prinderit, ne ditelindjen e pare te femijeve te tyre, u vendosin objekte te ndryshme perpara femijeve, ne menyre qe te zgjedhin njerin prej tyre. Objekti qe zgjedhin, tregon simbolikisht te ardhmen e tyre. Pikerisht ne ditelindje e saj te pare, Shqiperia Qiellore, zgjodhi Nenen e Paqes.*

Aktiviteti u mbyll me thirrjet e fitores “Eok Mansei” te drejtuara nga Arnold Grami, koordinator i Federatës së Familjes në Shkodër.



Raportoi stafi i Federatës së Familjes, Shqipëri